
 Republika e Kosovës Republika Kosovo Republic of Kosovo	<b>KUVËNDI I KOMUNËS SKUPŠTINA OPŠTINE MUNICIPAL ASSEMBLY</b>		 Komuna e Istogut Opština Istok Municipality of Istog
	00 Nr.Br.132/2022	Data: Datum: 26.09.2022	

Kuvendi i Komunës së Istogut në bazë të nenit 40.2 pika b) të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale nr.03/L-040 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr.28/2008) si dhe nenin 16 paragrafi 8 pika 8.1 dhe 8.2 i Ligjit Nr. 08/L-066 Mbi Ndarjet Buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2022, dhe nenit 33.1 pika 2. të Statutit të Komunës 01Nr.62/10, në mbledhjen e mbajtur më: 26.09.2022, shqyrtoi dhe miratoi propozimin e Kryetarit të Komunës për listën e projekte të reja kapitale në bashkëfinancim me komunitetin për vitin fiskal 2022, dhe merre këtë:

### V E N D I M

**PËR PROJEKTIN E RI KAPITAL NË BASHKËFINANCIM ME KOMUNITETIN  
“Ndërtimi i rrugëve në lagjen Osmanaj në Prekallë dhe lagjen Blakaj në  
Llukafc të Begut”.**

1. Miratohet propozimi i Kryetarit të Komunës për projektin e ri kapital në bashkëfinancim me komunitetin për vitin fiskal 2022.
2. Duke u bazuar në ligjin mbi ndarjet buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2022, projektet të cila komuna i ka me bashkëfinancim, me rastin e participimit të komitetit ose donatorëve tjerë në nivelin lokal me qeraste krijohet kod i ri të projekteve kapitale në tabelën 4.2, bazuar në projektin për bashkëfinancim “Projekti me participim te Komunitetetit ,ministrive te linjës,Donatoret e jashtëm “ me kod 50240.
3. Projekti “Ndërtimi i rrugëve në lagjen Osmanaj në Prekallë dhe lagjen Blakaj në Llukafc të Begut”.
4. Nga të cilat komuna e Istogut bashkë-finanon në shumën financiare prej : 10,000.00 euro, ndërsa komuniteti bashkë-finanon në shumën prej : 4,000.00 euro, totali i projektit në fjalë është gjithsej: 14,000.00 euro
5. Autorizohet Drejtoria për Buxhet dhe Financa dhe Zyrtari Kryesor Financiar që më planin e Rishikimit të buxhetit komunal të njoftojë Ministrinë e Ekonomisë dhe Financave për procedim të mëtejme në pajtim me Ligjin për menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësiive.
6. Ky Vendim hynë në fuqi 15 (pesëmbëdhjete) ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit të Ministrisë përgjegjëse për Vetëqeverisje Lokale, si dhe 7 (shtatë) ditë pas publikimit të tije në faqen zyrtare të Komunës. Për zbatimin e këtij Vendimi kujdesën: Kryetari i Komunës dhe Kryesuesi i Kuvendit të Komunës.

7. Me kopje të këtij Vendim të njoftohen: Departamenti i Buxhetit të Konsoliduar të Kosovës, Departamenti i Përgjithshëm i Thesarit në Prishtinë, Kryetari i Komunës, Zyrtari Kryesor Financiar (ZKF) dhe një kopje në arkivin e Kuvendit.

